



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 52
Prishtinë, më 2 mars 2017, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

P r o c e s v e r b a l

i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Elmi Reçica, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Ismet Beqiri, Puhie Demaku dhe Zafir Berisha.

Munguan: Teuta Rugova dhe Pal Lekaj.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Ambasador Mohamed ElOrabi dhe z. Ahmed El-Moslemany, Beqir Ismaili-Ambasador dhe Enis Xhemali-Akademia diplomatike.

Mbledhjen e kryesoi: Elmi Reçica, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Takim i Komisionit me delegacionin nga Republika Arabe e Egjiptit;
2. Të ndryshme.

Elmi Reçica i uroi mirëseardhje delegacionit nga Republika Arabe e Egjiptit dhe tha se kjo vizitë do të shërbejë në forcimin e marrëdhënieve dhe raporteve ndërshtetërore. Jemi mirënjohës për mbështetjen të cilën e ka dhënë dhe e jep Egjipti, duke shtuar se Egjipti ka një respekt të veçantë të qytetarët tanë. Ai tha se është koha që të lëvizet sa më shpejt në drejtim të forcimit të raporteve dhe marrëdhënieve dypalëshe, por njëkohësisht edhe të ndikohet te miqtë e përbashkët për t'i forcuar dhe zgjeruar raportet.

Ambasador Mohamed ElOrabi tha se në Egjipt ka mungesë të informatës për Kosovën dhe se do ta përcjellë mesazhin e miqësisë, të paqes, të vullnetit të mirë dhe të mundësive të mira për

bashkëpunim me të mirë. Ai njoftoi se Parlamenti i Egjiptit ka ngecje, se kanë një Kushtetutë të re dhe një President të zgjedhur nga populli. Lidhur me parlamentin njoftoi se ai ndahet në tri kategori, ku kategoria e parë i ka 120 anëtarë, kategoria e dytë janë të nominuarit nga Presidenti që janë 88 anëtarë dhe kategoria e tretë janë individë që vijnë nga të gjitha vendet e Egjiptit. Ai po ashtu njoftoi se në Parlamentin e Egjiptit janë të përfaqësuar 9 parti politike dhe se së paku 30 anëtarë të parlamentit e konsiderojnë vetën grup opozitar. Sa i përket lindjes së mesme tha se nuk është rajon stabil, se ka probleme në Irak, Libi, Siri, Sudan Jugor dhe se Egjipti po mundohet ta luaj rolin e oazës së stabilitetit në këtë turbulencë. Egjipti është duke i zhvilluar dy luftëra, lufta e parë është kundër terrorizmit dhe lufta e dytë është për zhvillimin e Egjiptit dhe kjo është arsyeja pse është ndërmarrënisma për reformimin e ekonomisë, njoftoi ambasadori. Ai më tej shtoi se në bashkëpunim me ambasadorin Ismaili do të organizohen aktivitete kulturore në mes të Kosovës dhe Egjiptit, kurse sa i përket bashkëpunimit ekonomik tha se tregtia është një shtyllë e rëndësishme dhe se do të vijë me një mision për bashkëpunim në fushën e tregtisë, veçanërisht në fushën e farmacisë. Shprehu mendimin se viti i ardhshëm do të jetë viti politik në mes të Egjipti dhe Kosovës, kurse ky vit do të tejkalohet duke zhvilluar aktivitete në fushën e kulturës dhe tregtisë. Sa i përket marrëdhënieve parlamentare tha se duhet të zhvillohet një vizitë zyrtare në Kajro, ku do të realizohet edhe një vizitë zyrtare në Komisionin homolog të Parlamentit të Egjiptit. Në fund ambasadori shtoi se kanë grumbulluar shumë material, i cili do të transmetohet në Televizionin e Egjiptit.

Elmi Reçicatha se interesi i përbashkët e dëshmon atë që mund të bashkëpunohet dhe të ecet përpara. Shteti i Egjiptit tha se është vend mik, është vend i madh me ndikim jo vetëm në rajonin e lindjes së mesme. Në Egjipt ka qenë një komunitet i fuqishëm shqiptar që ka kontribuar shumë për Egjiptin modern. Z. Reçica shprehu mendimin se historia është ajo që na bashkon, ndërsa e tashmja dhe e ardhmja e Egjipti dhe Kosovës është ajo që mund ta forcojë bashkëpunimin në mes të dy vendeve. Në fund z. Reçica shtoi se Kosova ka nevojë për mbështetje në atë pjesë të botës dhe se është problem që t'i sqarohet qytetarëve se, pse një pjesë e vendeve që duhet të njohin pavarësinë e Kosovës ende nuk e kanë njohur.

Ahmed El-Moslemanytha se kjo vizitë është dashur të realizohet më herët, dhe njoftoi se në ligjëratën e mbajtur në Bibliotekën Kombëtare ka thënë se pasqyra e Kosovës ka qenë vend i luftës, ndërsa tani është vend i paqes. Ai njoftoi se dëshirojnë të fillojnë një hap të ri, një dialog dhe një bashkëpunim intelektual në mes të Kosovës dhe Egjiptit dhe se në takim me ministrin e jashtëm ka propozuar që të formohet një forum bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Egjiptit. Ai u shpreh i kënaqur me Kushtetutën e Kosovës, e cila i jep të drejta të gjitha pakicave dhe se Kosova është shembull për një demokraci të fortë. Z. El-Moslemany, tha se Egjipti ka pranuar një dhuratë shumë të madhe nga populli shqiptar, ai është Muhamet Ali Pasha dhe shtoi se do t'i jepet një rëndësi të madhe marrëdhënieve në mes të dy vendeve. Kosova dhe Egjipti tha se mund të jenë urë lidhëse në mes lindjes dhe perëndimit dhe se e respektojnë Kosovën dhe popullin e saj. Në fund ai ftoi anëtarët e Komisionit që ta realizojnë një vizitë zyrtare në Egjipt.

Ismet Beqiri tha sesa i përket Kushtetutës së Kosovës ka një lloj diskriminimi pozitiv për komunitetet e tjera, gjë që nuk i bën dëm vendit. Shprehu mendimin se Kosova është një shembull i tolerancës dhe i respektit të ndërsjellë ndër fetar dhe ndëretnik. Sa i përket rolit të Egjiptit tha se është i një rëndësie të veçantë për Kosovën dhe se mund të ketë ndikim dhe të jetë ndihmesë për lobimin për njohjen e pavarësisë së Kosovës nga sa më shumë shtete. Ai tha se ka

hapësirë për bashkëpunim dhe se presin mbështetjen e Egjiptit. Bashkëpunimi në mes të parlamenteve dhe komisioneve është i mundur dhe duhet të punohet më tej në këtë drejtim, shtoi z. Beqiri.

Qerim Bajrami e falënderoi delegacionin që ka gjetur kohë ta vizitoi Komisionin tonë. Ai po ashtu falënderoi edhe ministrin tonë dhe ambasadorin Ismaili për aktivitetet që i kanë ndërmarrë për këtë vizitë. Z. Bajrami tha se i vjen mirë që delegacioni nga Egjipti e ka vizituar vendin tonë dhe ka marr informata të reja lidhur me Kosovën, të cilat do t'i përcjellë në Egjipt dhe në vendet arabe. Më tej ai theksoi se përfaqëson komunitetin jo shumicë të boshnjakëve në Parlamentin e Kosovës, për të cilin kolegët thanë se kemi shumë të drejta, për të cilat tha se nuk do të flas. Z. Bajrami bëri të ditur se edhe në kohën e tashme kultura egjiptiane ka një ndikim në Kosovë sepse një pjesë e mirë e jona është shkolluar në Kajro dhe kjo kulturë ka ndikim te ne. Z. Bajrami njoftoi delegacionin edhe për atë se Beogradi më nuk është selia e lëvizjes së të painkuadruarvenë Ballkan dhe se serbet dhe Serbia nuk janë trashëgimtar të asaj lëvizje. Pas tjerash z. Bajrami theksoi se Kosova dëshiron të bashkëpunojë me Egjiptin dhe shpreson se së shpejti do të hapen ambasadat ne vendet tona e njëkohësisht Komisioni ynë ta realizojë një vizitë zyrtare në Parlamentin e Egjiptit.

Elmi Reçica tha se ne duam që të kemi raporte sa më të afërta me Egjiptin, ta zhvillojmë diplomacinë parlamentare dhe njoftoi se Kuvendi i Kosovës ka edhe grup të miqësisë me Egjiptin. Ai më tej tha se Kosova ka nevojë për mbështetjen e Egjiptit, se janë të gatshëm ta thellojnë bashkëpunimin dhe se janë po ashtu të gatshëm që ta realizojnë vizitën në Kajro. Z. Reçica tha se do të angazhohen që të vendosen marrëdhënie diplomatike dhe të hapen ambasadat në Kajro dhe në Prishtinë dhe se janë të interesuar që marrëdhëniet bilaterale të thellohen dhe zgjerohen si në aspektin ekonomik, kulturor, dhe atë politik. Ai tha se jemi popull që jetojmë në Evropë dhe synojmë BE-në dhe NATO-në, dhe se interesi i Egjiptit është që të ketë raporte të mira me ShBA-në dhe Kosova e ka po atë orientim. Z. Reçica, njoftoi se Rusia në Ballkan është shumë aktive, ka koordinim të mirë me Serbinë dhe për Kosovën këto dy shtete ende nuk kanë dëshmuar se janë miqësore. Në kuadër të këtyre zhvillimeve Kosova përpiqet që të gjejë aleatë të rinj dhe të krijojë aleanca të reja dhe njëkohësisht edhe t'i forcojë aleancat e vjetra.

Ambasador Mohamed ElOrabi, tha se kjo vizitë është e nivelit të lartë dhe se delegacioni i këtij niveli nuk ka qenë as në Beograd. Ai shtoi se kjo është një iniciativë e re që është ndërmarrë dhe shprehu mendimin se ju jeni të privilegjuar që keni pasur rastin të takoni një delegacion të nivelit të tillë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Elmi Reçica